

Vendim nr. 273, datë 29.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Marjana Semini, Anëtare

Illir Toska, Anëtar

në datën 29.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 25 (B) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: BLENDAR PAJA, përfaqësuar nga avokat Dritan Jahaj, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi pjesërisht i vendimeve nr. 467, datë 29.07.2024 të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 43 (87-2024-267), datë 19.09.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-148, datë 30.01.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si vendime që kanë shkelur standardet e procesit të rregullt ligjor; që kanë cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën e pronësisë në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; që kanë cenuar të drejtën për mjete efektive ankimi, në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kundër vendimeve që cenojnë të drejtën e tij konventore të pronës dhe të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor në mbrojtjen e së drejtës së pronës.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131 dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1; nenet 49, 50 dhe 51 të ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 14.04.2022 Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar një procedim penal (*procedimi penal nr. 75/2022*), ndaj disa shtetasve, si të dyshuar për veprat penale “Vrasja me paramendim”, e mbetur në tentativë dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe e municionit”, të kryera në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuara nga nenet 78, paragrafi 2 e 22, 278, 28, paragrafi 4, 333/a dhe 334 të Kodit Penal (*KP*), si dhe për veprat penale dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe e municionit”, e kryer në bashkëpunim dhe “Përkrahja e autorit të krimit”, të parashikuar nga nenet 278 dhe 302 të KP-së.

2. Gjatë hetimit paraprak të këtij procedimi penal, si rezultat e bashkëpunimit me organet e drejtësisë të disa prej personave të hetuar, janë zbuluar të dhëna të rëndësishme me interes edhe për disa ngjarje të rënda kriminale, të pazbuluara më parë, për disa vrasje, vrasje të mbetura në tentativë, krijim të kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje, vjedhje me dhunë dhe me armë, vepra dhune, shkatërrim prone me lëndë plasëse etj. Mbështetur në këto të dhëna, por edhe atyre të mbledhura më parë, është arritur në identifikimin e disa autorëve të dyshuar të këtyre

veprave penale, ndërsa procedimet e regjistruara më parë janë rifilluar dhe bashkuar në një procedim penal të vetëm.

3. Në kuadër të këtij procedimi penal, përmes bashkëpunimit edhe me autoritetet gjyqësore të huaja, janë administruar të dhëna mbi komunikime të shtetasve shqiptarë në aplikacionin SkyEcc, nga të cilat, të ndërthurura edhe me ato të mbledhura gjatë hetimit paraprak, është ngritur dyshimi për ekzistencën e një organizate kriminale të përfshirë në trafikun ndërkombëtar të drogës, kryesisht të kokainës, vrasjeve me pagesë, sigurimin e kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje, korrupsionin e funksionarëve të sistemit të drejtësisë, rekrutimin e punonjësve të policisë për marrjen e informacioneve me vlerë për qëllimet e organizatës, si dhe pastrimin e produkteve të veprimtarisë së tyre kriminale. Është ngritur dyshimi se organizata kriminale është krijuar dhe drejtohej nga tre shtetas të identifikuar dhe lidhjet e tyre në Amerikën Latine, ku sigurohej lëndë narkotike dhe në Evropë, ku ajo eksportohej dhe shpërndahej. Anëtarët e organizatës dyshohej, po ashtu, se kanë rekrutuar lidhje të tyre shoqërore, miqësore dhe bashkëpunuese edhe në Shqipëri, ku përmes të cilave, një pjesë të të ardhurave të gjeneruara nga trafiku ndërkombëtar i drogës i kanë investuar kryesisht në sektorin e ndërtimit dhe të pasurive të paluajtshme. Janë siguruar të dhëna, sipas të cilave anëtarët e organizatës kanë krijuar operatorë ekonomikë dhe regjistruar ata në emër të lidhjeve të tyre ose kanë përdorur operatorë ekzistues, duke mos ekspozuar poseduesit *de facto* dhe përdorur lidhjet e tyre si kamuflim/koperturë, me qëllim pastrimin e parave të gjeneruara nga aktiviteti kriminal. Po ashtu, janë siguruar të dhëna se personi nën hetim A, i dyshuar si kreu i organizatës kriminale, në disa raste, ka bërë transferim të vlerave monetare të konsiderueshme nëpërmjet përdorimit të zyrave të këmbimit valutor (Exchange) brenda dhe jashtë vendit, duke ua dërguar personave të besuar, me qëllim bërjen e pagesave për ngarkesat e lëndës narkotike, si dhe për kryerjen e investimeve në Shqipëri, por edhe jashtë saj. Po ashtu, janë siguruar të dhëna edhe për blerjen e pasurive të paluajtshme dhe regjistrimin e tyre në emër të personave të tretë, me qëllim fshehjen/zhdukjen e origjinës së burimit të të ardhurave, si produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale.

4. Ndër të tjera, janë siguruar të dhëna se shtetasi B është një nga personat e besuar të personit nën hetim A. Dyshohet se ai menaxhon vlera monetare në sasi të konsiderueshme për llogari të personit nën hetim A dhe se ka kryer veprime aktive për pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale. Ky shtetas, ndër të tjera, dyshohet se ka marrë nga kreu i dyshuar i organizatës kriminale vlera monetare të konsiderueshme në formë huaje në informalitet

dhe i ka investuar në sektorin e ndërtimit, me qëllim formalizimin e tyre për llogari të A. Po ashtu, ky shtetas ka shitur pasuri të paluajtshme për llogari të personit nën hetim A, përmes personave të tretë në lidhje familjare, miqësore ose bashkëpunuese me të. Nga deklaratimet e bashkëpunëtorëve të drejtësisë, por edhe nga të dhënat në aplikacionin SkyEcc, janë siguruar të dhëna se mes personave nën hetim A dhe B është biseduar edhe për dy vila, që A dhe vëllai i tij (edhe ai person nën hetim) kanë marrë në vitin 2020 në kompleksin e banimit që ndërtonte në Tiranë shoqëria “X”, e krijuar nga B dhe aktualisht e vëllait të tij. Në bisedë, përveç vendndodhjes, vilat janë identifikuar me ngjyrë dhe numër. Ndërkohë, në datën 06.06.2024 është kryer këqyrja e regjistrit elektronik të kadastrës në lidhje me pasuri të regjistruara në emër të shoqërisë “X” dhe, në vijim, në datën 07.06.2024, është realizuar këqyrja e këtij regjistri për pasuri të kësaj shoqërie me vendndodhje në kompleksin e banimit në Tiranë. Nga kjo këqyrje, referuar të dhënave të bisedës mes A dhe B, është konstatuar se një nga vilat figuronte e regjistruar, me status “regjistrim i përkohshëm”, në emër të kërkuesit Bledar Paja. Sipas një kontrate noteriale shitblerjeje, kërkuesi e ka blerë këtë pasuri nga shoqëria “X” në datën 28.07.2023.

5. Në datën 27.07.2024 Prokuroria e Posaçme, bazuar në nenin 274 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), i ka kërkuar gjykatës vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, ndër të tjera, edhe mbi pasurinë e regjistruar në emër të kërkuesit, për shkak se ekzistonin dyshime të arsyeshme se ajo ishte produkt i veprës penale, i gjeneruar me të ardhura të përftuara nga aktiviteti kriminal (trafikimi i narkotikëve) i organizatës kriminale, anëtarë të së cilës janë nën hetim dhe se disponimi i lirë i saj mund të rëndonte ose zgjaste pasojat e veprës penale.

6. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 467, datë 29.07.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, duke caktuar masën e sigurimit pasuror të sekuestros preventive edhe mbi pasurinë e paluajtshme të regjistruar në emër të kërkuesit dhe ka ngarkuar Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara për administrimin dhe përdorimin e saj. Ajo gjykatë ka vlerësuar, në kuptim të përmbajtjes së nenit 274 të KPP-së, praninë e elementeve *fumus delicti* dhe *periculum in mora* si kushte për vendosjen e masës së sekuestros preventive, duke evidentuar në vijim parashikimet e pikës 2 të kësaj dispozite. Në këtë kuadër, sipas saj, evidentohet prania e elementit *fumus commissis delicti* dhe atij të lidhjes së posaçme, funksionale dhe jo të rastësishme mes sendit dhe veprimit penal të kundërligjshëm. Sipas gjykatës, ka dyshime të arsyeshme se personi nën hetim A në bashkëpunim

edhe me persona të tjerë nën hetim, por edhe me persona ende të paidentifikuar, kanë kryer veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe se ekziston dyshimi se edhe pasuria e paluajtshme e regjistruar në emër të kërkuesit mund të jetë produkt i veprimtarisë kriminale në kuptim të nenit 36 të KP-së, duke gjetur të drejtë lidhjen që Prokuroria e Posaçme ka bërë midis kësaj pasurie dhe veprimtarisë kriminale që dyshohet se është kryer. Në vijim, gjykata ka vlerësuar se disponimi i lirë i kësaj pasurie mund të sjellë tjetërsimin e saj tek të tretët dhe, për rrjedhojë, do të rëndonte pasojat e veprës penale.

7. Vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë është ekzekutuar nga oficeri i Policisë Gjyqësore. Gjatë ekzekutimit është konstatuar se pasuria e kërkuesit përdorej nga një person tjetër, sipas një kontrate qiraje që datonte më 02.08.2023. Pasi është njohur me vendimin e sekuestros, kërkuesi (avokati i tij) ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit. Po ashtu, është paraqitur ankim edhe nga persona të tjerë të prekur nga urdhërimet e vendimit për vendosjen e masës së sekuestros preventive për pasuri të tjera. Ankimet janë bashkuar dhe shqyrtuar në një gjykim të vetëm. Në përfundim, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 43 (87-2024-267), datë 19.09.2024, ndër të tjera, ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë në lidhje me vendosjen e sekuestros preventive për pasurinë e regjistruar në emër të kërkuesit. Edhe sipas asaj gjykate, ekzistojnë kriteret ligjore që masa synon, nëpërmjet shmangies së disponimit të lirë të sendit, produkt i veprës penale, në ndalimin e rëndimit ose të zgjatjes së pasojave të veprës penale tashmë të dyshuar si të konsumuar dhe eliminimin e rrezikut të rëndimit ose të zgjatjes së pasojave të saj ose lehtësimin e kryerjes së veprave të tjera penale. Ajo gjykatë ka vlerësuar se për vendosjen e masës së sigurimit pasuror, sikurse dhe sekuestroja preventive, kërkohet ekzistenca e dyshimit, prova e krimit (*fumus delicti*), duke qenë e parëndësishme njohja e autorit të krimit ose fajësia e tij, sikundër edhe përkatësia e pronësisë së sendit. Sipas saj, në rastin konkret krijohet dyshimi i arsyeshëm se personat nën hetim, të identifikuar si pjesëtarë të një organizate kriminale që merret me trafikun ndërkombëtar të drogës, të ardhurat e gjeneruara nga ky aktivitet i kanë investuar edhe në Shqipëri, në sektorin e ndërtimit dhe të pasurive të paluajtshme, ku në bashkëpunim edhe me persona të tjerë, po ashtu dyshohet se kanë konsumuar edhe veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale. Ajo ka vlerësuar se pasuria e vendosur nën sekuestron preventive është një pasuri që mund të konfiskohet në kuptim të nenit 36, pika 1, shkronja “b” dhe pika 2, të KP-së, duke qenë i zbatueshëm në këtë rast neni 274, pika 2, i KPP-së, për vendosjen e sekuestros së

mundshme funksionale, pasi nga disponimi i lirë i saj krijohet rrezik/dëm nga vonesa ose *periculum in mora* deri në kalimin e vendimit në gjë të gjykuar. Gjykata e apelit ka vlerësuar se masa kufizuese e së drejtës së pronësisë në rastin konkret është në përputhje me standardet kushtetuese dhe ato konventore, pasi kufizimi parashikohet nga ligji, është i nevojshëm dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Nga ana tjetër, në lidhje me pretendimin e kërkuarit për fitimin e pasurisë në mënyrë të ligjshme dhe me të ardhura nga burime të ligjshme, gjykata është shprehur se kjo është një çështje që mbetet të verifikohet gjatë vijimit të hetimit të procedimit penal dhe se në këtë fazë të procedimit nuk ka asnjë pengesë ligjore për mbajtjen e sekuestros preventive, për sa kohë pasuria dyshohet të jetë produkt i veprës penale, duke qenë e parëndësishme për ligjin përkatësia e pronësisë së saj.

8. Për rekursin e kërkuarit, por edhe të disa personave të tjerë të prekur nga sekuestroja preventive, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-148, datë 30.01.2025, ndër të tjera, ka vendosur mospranimin e tyre. Për sa i përket rekursit të kërkuarit, ai kolegji ka arritur në përfundimin se shkaqet e parashtruara nuk referojnë në përcaktimet e nenit 432, pika 1, të KPP-së, pasi nuk janë të tilla që të paraqesin rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk sjellin pasojë në vlefshmërinë e vendimit, si dhe nuk evidentohet që vendimi i kundërshtuar të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara. Ai kolegji ka vërejtur se GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar mjaftueshëm në lidhje me ekzistencën e kushteve ligjore për vendosjen dhe mbajtjen e masës së sekuestros preventive, duke mos pasur shkaqe për cenimin e vendimmarrjes së saj. Në veçanti, ai ka vlerësuar se pavarësisht pretendimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së sekuestruar dhe akteve në mbështetje të tij, nga arsyetimi i gjykatave më të ulëta konstatohet se aktet provuese të organit procedues janë të afta për krijimin e dyshimit për caktimin e masës së sigurimit pasuror. Po sipas tij, hetimet paraprake kanë karakter dinamik dhe kështu vendimmarrjet e kësaj faze mund të shqyrtohen periodikisht dhe, në këtë kuptim, çdo i interesuar që është prekur nga masa e sekuestros mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore në varësi të të dhënave të grumbulluara gjatë hetimeve paraprake ose zhvillimeve të ndodhura. Ai ka theksuar se objekt sekuestrimi preventiv mund të jetë çdo e mirë (pasuri) ndaj kujtdo që i përket, për rrjedhojë edhe ndaj një personi që nuk ka lidhje me krimin, për sa kohë që, megjithëse në mënyrë indirekte, pasuria është e lidhur me krimin dhe, nëse lihet lirisht në dispozicion, mund të përbëjë rrezik për rëndimin ose zgjatjen e pasojave të veprës penale ose lehtësimin e kryerjes së fakteve të mëtejshme penale. Po ashtu,

kolegji ka gjetur të drejtë argumentimin e gjykatës së apelit në lidhje me kufizimin e përkohshëm të së drejtës kushtetuese të pronës, duke vlerësuar se interesi publik justifikon masën, pasi kufizimi është i parashikuar nga ligji, ka qenë i nevojshëm dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar.

9. Në datën 31.07.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

10. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

11. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

11.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

11.1.1. *Së drejtës për gjykim nga një gjykatë e pavarur*, pasi GJKKO-ja e Apelit, në vend që të marrë në konsideratë provat e kërkuesit, kujdeset që të ndreqë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, në versionin e dytë, sepse kishte kuptuar që veprat penale për të cilat kishte procedim penal nuk përfshinin mundësinë e krijimit të pasurisë përmes kryerjes së tyre. Qëndrimi i GJKKO-së së Apelit është haptazi i njëanshëm dhe synon të mbështesë në mënyrë të padrejtë strategjinë e prokurorisë, e cila nuk ka regjistruar procedim penal për veprat penale të tregtimit të lëndëve narkotike ose të pastrimit të produkteve të veprës penale.

11.1.2. *Së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve*, për shkak se:

11.1.2.1. Kërkuesi nuk ka pasur akses në prova, duke mos pasur mundësi reale për t’u mbrojtur ndaj atyre fakteve, të cilat kanë bërë prokurorinë dhe gjykatat të besojnë në nevojën e aplikimit të nenit 274 të KPP-së për sekuestrimin e pronës së tij. Ai nuk di se cilat hetime tregojnë se prona e tij është e lidhur me veprat penale për të cilat është regjistruar procedimi penal dhe, po ashtu, vendimet e gjykatave nuk përmbajnë as rreziqet për

përkeqësimin e pasojave të veprave penale ose për kryerjen e veprave penale të tjera, që synohen të parandalohen përmes sekuestrimit.

- 11.1.2.2. Megjithëse në ankimin e tij kërkuesi ka paraqitur prova të dokumentuara që lidhen me blerjen e pronës, si dhe burimin e fondeve të përdorura për blerjen e saj, ende sot nuk është në dijeni nëse gjykata e apelit i ka konsideruar këto prova dhe nëse i ka konfrontuar ato me provat e prokurorisë, ndërkohë që në arsyetimin e saj ato nuk referohen. Në këtë mënyrë, kërkuesit nuk i është mundësuar një procedurë e drejtë, duke mos iu garantuar atij mundësia efektive për rrëzimin e dyshimeve të prokurorisë. Ky cenim bëhet i dukshëm nga fakti i vlerësimit të përbashkët të sekuestros nga gjykatat për të gjitha pronat e personave të prekur nga sekuestrimi, duke mos u bërë analizë e mëvetshme për secilën nga ato dhe për secilin pronar të tyre.
- 11.1.3. *Së drejtës së ankimit*, për shkak të mungesës së mjeteve efektive për të kundërshtuar masën e sekuestrimit. Pavarësisht se neni 276 i KPP-së lejon ankimin kundër vendimit të sekuestrimit dhe kërkuesi e ka ushtruar këtë të drejtë, si dhe ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, mënyra sesi kanë vepruar GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë kthyer këto mjete në mundësi tërësisht teorike, duke cenuar nenin 13 të KEDNJ-së. Në rastet e kufizimit të së drejtës së pronës private në kuadër të procedimeve penale, individët duhet të kenë mundësinë të kundërshtojnë sekuestrimin në një proces të drejtë, duke iu dhënë atyre arsyet e sekuestrimit dhe provat që kanë çuar në marrjen e vendimit, me qëllim që mundësia e kundërshtimit të mos mbetet thjesht teorike. Kërkuesi nuk është person nën hetim dhe për sa ishte e mundur e ka kundërshtuar sekuestrimin dhe ka paraqitur prova, por GJKKO-ja e Apelit nuk i ka vlerësuar ato, madje as i ka përmendur në vendimin e saj. Në këto kushte, mjetet e ankimit të parashikuara në nenin 276 të KPP-së nuk përbëjnë edhe *in abstracto* mjete efektive në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, në rastet kur sekuestrohen pasuri të personave që nuk janë nën hetim, të cilëve për këtë shkak nuk u njoftohen provat e prokurorisë në mbështetje të kërkesës, përveçse gjykata e apelit nuk pranon të marrë në shqyrtim provat e tyre, sikurse edhe në rastin e kërkuesit.

11.1.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, për shkak se:*

- 11.1.4.1. Vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë është prodhuar në dy versione, ku ai i emërtuar “shkurtim vendimi” i është vënë kërkuesit në dispozicion në datën 26.08.2025, kurse versioni tjetër i është vënë në dispozicion gjatë gjykimit në apel. Versioni i parë i vendimit nuk përmban as formalisht një seksion që të përbëjë arsytimin e vendimit, sikurse versioni i dytë. Megjithëse kërkuesi ngriti pretendime për prodhimin e vendimit në dy versione, GJKKO-ja e Apelit nuk bëri asnjë hetim dhe as e ka përmendur atë në vendimin e saj. Megjithatë, edhe në versionin e zgjeruar të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë nuk ka asnjë referim në raport me kërkuesin.
- 11.1.4.2. GJKKO-ja e Apelit nuk trajtoi asnjë nga pretendimet e ngritura nga kërkuesi në ankim për sa u takon mangësive të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ajo nuk dha asnjë shpjegim se pse një vendim që nuk përmban asnjë arsytim është i vlefshëm në kuptim të nenit 112 të KPP-së, nëse një vendim i tillë mund të vihej në ekzekutim ose nëse ai përbën ose jo cenim të së drejtës së personit të prekur nga sekuestrimi për të kundërshtuar dhe mbrojtur nga sekuestrimi.
- 11.1.4.3. Vendimet e gjykatave më të ulëta karakterizohen nga një arsytim i përgjithshëm, pasi në to nuk ka asnjë referim, asnjë rrethanë dhe asnjë arsytim që të shpjegojë, qoftë edhe përciptas se cilat ishin nevojat e sigurimit që bënin të nevojshëm sekuestrimin e pasurisë së zotëruar nga kërkuesi. Në to mungon arsytimi për lidhjen e sendit me veprat penale, për më tepër kur veprat penale për të cilat ka dyshime, për nga natyra, në përgjithësi nuk krijojnë përfitime pasurore. Po ashtu, është i errët arsytimi për rrezikun që disponimi i lirë i sendit mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e veprës penale, ndërsa nuk tregohet vepra penale për të cilën ka filluar procedimi penal dhe as ato që mund të kryhen për shkak të disponimit të lirë nga kërkuesi të pronës së tij të sekuestruar. Ato gjykata në drejtim të analizës së verifikimit të kritereve të proporcionalitetit dhe ndërhyrjes në të drejtën e pronës janë mjaftuar me

një arsyetim formal dhe nuk kanë arsyetuar se përse një kufizim tjetër nuk do të arrinte në të njëjtën mënyrë qëllimin e procedimit penal. Edhe Gjykata e Lartë, duke iu shmangur analizës së thelbit të pretendimeve të ngritura, veçanërisht atyre që lidhen me statusin e kërkuesit si palë e tretë, në mirëbesim ka lënë në fuqi një vendim arbitrar të pambështetur në prova dhe në kundërshtim me standardet e vendosura nga jurisprudenca. Vendimi i Gjykatës së Lartë është një përsëritje e përgjithshme e arsytimit të gjykatës së apelit, pa sqaruar se një bisedë e vetme midis dy personave pa asnjë lidhje midis tyre përmbush standardin e “dyshimit” të nevojshëm për të justifikuar sekuestrimin e pasurisë së një blerësi me mirëbesim.

11.2. *E drejta e pronës private*, pasi:

11.2.1. Gjykatat më të ulëta edhe pse i referohen jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, ato nuk kanë vlerësuar standardet e vendosura nga ajo për kufizimin e së drejtës së pronës. Është e vërtetë se autoritetet kanë mundësi të sekuestrojnë një send të lidhur me veprën penale sipas nenit 274 të KPP-së, por nevoja e parandalimit që kërkohet nga ky nen duhet të vlerësohet nga autoritetet në mënyrë të kujdesshme dhe po ashtu, duke i dhënë mundësi individit të prekur të ketë një proces të ndershëm. Nëse gjatë procedurave nuk ka qartësi për nevojën e sekuestrimit, të kufizimit të pronës private, kjo përbën shkelje të këtij standardi edhe pse mjeti është parashikuar me ligj. Në rastin konkret, gjykatat nuk janë kujdesur për të analizuar në mënyrë të saktë lidhjet e pasurisë së kërkuesit me veprat penale për të cilat është regjistruar procedimi penal. Ato e kanë lidhur sekuestrimin me vepra penale për të cilat nuk ka procedim dhe mbi të gjitha, kërkuesi nuk përmendet në asnjë prej vendimeve dhe gjykatat përdorin rrethana që lidhen me individë të tjerë, duke e bërë haptazi të padrejtë qëndrimin e autoriteteve për përdorimin e mundësisë së lejuar nga neni 274 i KPP-së, duke mos ruajtur standardet e GJEDNJ-së, veçanërisht e rëndësishme kjo për Gjykatën e Lartë, si gjykatë ligji, e cila nuk ka kryer asnjë vlerësim dhe nuk ka

pranuar të shqyrtojë rekursin e kërkuarit, edhe pse ai u referohej standardeve konventore dhe shkeljes së tyre.

11.2.2. Barra e provës e vendosur mbi kërkuarin është haptazi joproporcionale, pasi kërkuari është shtetas i huaj, i cili ka investuar të ardhura të ligjshme nga aktiviteti i tij ekonomik shumëvjeçar jashtë shtetit dhe nëpërmjet një procesi transparent dhe ligjor. Privimi i kërkuarit nga prona e tij për më shumë se një vit bazuar vetëm në një bisedë të dyshimtë midis dy personave nën hetim, me të cilët ai nuk ka asnjë lidhje, cenon thelbin e sigurisë juridike dhe së drejtës së pronës së tij. Mbajtja e pronës në sekuestro po i shkakton kërkuarit një dëm të vazhdueshëm dhe të pariparueshëm. Ky dështim për të marrë masa më pak të rënda e bën vendimin arbitrar dhe në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit.

11.2.3. Interesi publik për të luftuar krimin e organizuar nuk mund të justifikojë sakrifikimin e të drejtave themelore të qytetarëve të pafajshëm përmes masave arbitrare dhe të paarsyeshme.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Kolegji vëren se kërkuari ka kundërshtuar procesin gjyqësor në të cilin ka qenë palë dhe përmes të cilit është vendosur sekuestrimi i pasurisë

në pronësi të tij, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës.

14. Në lidhje me kriterin *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 5, datë 17.03.2022; nr. 14, datë 11.03.2022; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Si përjashtim, Gjykata ka vlerësuar se vendimet për vendosjen e masës së sekuestrimit, ndonëse me karakter të përkohshëm dhe nuk vendosin për themelin e çështjes, ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale, ndaj konsiderohen me natyrë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 33, datë 20.05.2025; nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në çështjen konkrete, në aspektin procedural, Kolegji vëren se kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe pasi ka shteruar në formë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta për vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestrimit preventive, ndaj në këto rrethana vendimi që ka përmbyllur procesin gjyqësor konsiderohet përfundimtar për efektet e gjyimit kushtetues.

16. Në lidhje me aspektin substancial, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të *së drejtës për gjykim nga një gjykatë e pavarur*, me argumentin se GJKKO-ja e Apelit, duke u kujdesur për ndreqjen e arsytimit të gjykatës së shkallës së parë, në versionin e dytë, ndërsa ka kuptuar që veprat penale për të cilat kishte procedim penal nuk përfshinin mundësinë e krijimit të pasurisë përmes kryerjes së tyre, ka mbajtur qëndrim haptazi të njëanshëm, duke mbështetur në mënyrë të padrejtë organin e prokurorisë.

17. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve*, kërkuesi ka parashtruar si argumente se: i) nuk ka pasur akses në provat e prokurorisë dhe, për pasojë, nuk ka pasur mundësi reale të kundërshtojë faktet që u përdorën për të justifikuar sekuestrimin (neni 274 KPP) e pronës së tij. Sipas tij, ai nuk i di hetimet që lidhin pronën e tij me veprat penale për të cilat është regjistruar procedimi penal dhe vendimet gjyqësore nuk shpjegojnë

rreziqet që synohen të parandalohen përmes sekuestrimit; ii) megjithëse ka paraqitur prova dokumentare për blerjen e pronës dhe burimin e fondeve, është e paqartë nëse këto janë shqyrtuar dhe janë ballafaquar me provat e prokurorisë, pasi nuk pasqyrohen në arsyetimin e vendimit të GJKKO-së së Apelit. Sipas tij, kjo i ka mohuar një procedurë të drejtë dhe një mundësi efektive për të rrëzuar dyshimet e prokurorisë, dhe ky cenim bëhet më i dukshëm nga fakti që gjykatat e trajtuan sekuestron në mënyrë të përgjithshme për të gjitha pronat, pa analizë të veçantë për secilin pronë dhe secilin pronar.

18. Nga aktet dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi, Kolegji konstaton se kërkuesi këto pretendime nuk i ka ngritur më parë në rekursin e paraqitur prej tij në Gjykatën e Lartë, por i ka parashtruar për herë të parë vetëm në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për këto pretendime ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim. Kurse pretendimet e tjera kërkuesi i ka ngritur në substance përpara gjykatave të zakonshme, duke mos pasur kështu mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

19. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi gjyqësor më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 30.01.2025, i cili, sipas kërkuesit i është komunikuar në datën 01.04.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 31.07.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

20. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të mungesës së mjeteve efektive për të kundërshtuar masën e sekuestrimit, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ashtu edhe të së drejtës së pronës private, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, në lidhje me ligjshmërinë e masës së sekuestros preventive.

21. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së ankimit për shkak të mungesës së mjeteve efektive për të kundërshtuar masën e sekuestros, kërkuesi ka parashtruar se ndonëse neni 276 i KPP-së lejon ankimin kundër vendimit të sekuestrimit dhe ai ka ushtruar këtë të drejtë, mënyra sesi kanë vepruar GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë e kanë bërë mjetin ankues vetëm formal e teorik, në kundërshtim me nenin 13 të KEDNJ-së. Sipas tij, duke qenë se nuk është person nën hetim, ai nuk është njoftuar me provat e prokurorisë që mbështesin kërkesën për sekuestro

dhe, për më tepër, GJKKO-ja e Apelit nuk ka pranuar të shqyrtojë e të vlerësojë provat e paraqitura prej tij. Në këtë kuptim, duke mos i dhënë arsytet dhe provat që kanë çuar në sekuestrim, mundësia për të kundërshtuar kufizimin e së drejtës së pronës private ka mbetur thjesht teorike.

22. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, kërkuesi ka parashtruar si argumente se: i) vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë është nxjerrë në dy versione, ku versioni i parë (“shkurtim vendimi”) nuk ka as formalisht një seksion që të përbëjë arsyetim dhe, megjithëse ai e ngriti këtë çështje, GJKKO-ja e Apelit nuk e hetoi dhe as e përmendi në vendimin e saj, ndërkohë që edhe versioni i dytë i zgjeruar i vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë nuk përmban referime në raport me të (kërkuesin); ii) GJKKO-ja e Apelit nuk trajtoi pretendimet e tij në ankim për mangësitë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe nuk shpjegoi pse një vendim si ai i versionit të parë është i vlefshëm sipas nenit 112 të KPP-së, nëse mund të ekzekutohej dhe nëse kjo situatë cenon të drejtën e tij për kundërshtimin dhe mbrojtjen nga sekuestrimi; iii) vendimet e gjykatave më të ulëta nuk shpjegojnë, qoftë dhe përciptas, nevojat e sigurimit që e bënin të domosdoshëm sekuestrimin e pronës së tij, nuk arsyetojnë lidhjen e sendit me veprat penale dhe mbeten të paqarta për rrezikun që disponimi i lirë i sendit mund të rëndojë ose zgjasë pasojat e veprës penale, ndërsa nuk tregohet as vepra penale për të cilën është regjistruar procedimi dhe as ato që mund të kryheshin si pasojë e disponimit të lirë. Sipas tij, gjykatat në drejtim të analizës së verifikimit të kriterëve të proporcionalitetit dhe ndërhyrjes në të drejtën e pronës janë mjaftuar me një arsyetim formal dhe nuk kanë arsyetuar se përse një kufizim tjetër nuk do të arrinte në të njëjtën mënyrë qëllimin e procedimit penal; iv) vendimi i Gjykatës së Lartë është një përsëritje e përgjithshme e arsytimit të gjykatës së apelit, pa sqaruar se një bisedë e vetme midis dy personave pa asnjë lidhje midis tyre përmbush standardin e “dyshimit” të nevojshëm për të justifikuar sekuestrimin e pasurisë së një blerësi me mirëbesim.

23. Kurse në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës së pronës private*, kërkuesi ka parashtruar se ndonëse gjykatat i janë referuar nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, ato nuk kanë zbatuar standardet e saj për kufizimin e pronës. Sipas tij, edhe pse neni 274 i KPP-së lejon sekuestrimin e sendeve të lidhura me veprën penale, nevoja parandaluese që justifikon këtë masë duhet të vlerësohet me kujdes nga autoritetet, duke i dhënë mundësi individit të prekur të ketë një proces të ndershëm. Mungesa e qartësisë mbi nevojën e sekuestrimit, shprehet ai, përbën shkelje, edhe pse mjeti është parashikuar me ligj. Në rastin konkret, vijon ai, gjykatat nuk kanë analizuar saktë lidhjet e pasurisë së tij me veprat penale për të

cilat është regjistruar procedimi penal, madje ato e kanë lidhur sekuestrimin me vepra penale për të cilat nuk ka procedim dhe, mbi të gjitha, ai nuk përmendet në vendimet e tyre dhe gjykatat janë mbështetur në rrethana që lidhen me individë të tjerë. Sipas tij, kjo e bën qëndrimin e autoriteteve haptazi të padrejtë dhe në kundërshtim me standardet e GJEDNJ-së, veçanërisht pasi Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, nuk ka kryer vlerësim dhe as ka pranuar të shqyrtojë rekursin, megjithëse ai referonte shkelje të standardeve konventore. Barra e provës e vendosur mbi kërkuesin është haptazi joproporcionale, pasi kërkuesi është shtetas i huaj, i cili ka investuar të ardhura të ligjshme nga aktiviteti i tij ekonomik shumëvjeçar jashtë shtetit dhe nëpërmjet një procesi transparent dhe ligjor. Privimi i kërkuesit nga prona e tij për më shumë se një vit bazuar vetëm në një bisedë të dyshimtë midis dy personave nën hetim, me të cilët ai nuk ka asnjë lidhje, cenon thelbin e sigurisë juridike dhe së drejtës së pronës së tij. Mbajtja e pronës në sekuestro po i shkakton kërkuesit një dëm të vazhdueshëm dhe të pariparueshëm. Ky dështim për të marrë masa më pak të rënda e bën vendimin arbitrar dhe në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit. Interesi publik për të luftuar krimin e organizuar nuk mund të justifikojë sakrifikimin e të drejtave themelore të qytetarëve të pafajshëm përmes masave arbitrare dhe të paarsyeshme.

24. Gjykata ka theksuar se në rastin përjashtimor të kontrollit të vendimeve që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm, ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar, ndaj, në këtë kuptim, ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për rrjedhojë, për sa kohë që pretendimet në drejtim të së drejtës për proces të rregullt në aspektin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor kanë të bëjnë, në thelb, me përcaktimin e fakteve dhe mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të dispozitave procedurale penale që përcaktojnë kriteret për vendosjen e masës së sekuestros preventive, ato do të shqyrtohen në kuadër të së drejtës substanciale të pronës private, sipas nenit 41 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në raport me nenin 17 të Kushtetutës, që lejon kufizimin e të drejtave kushtetuese sipas kriterëve të përcaktuara prej tij. Në këtë kuptim, bazuar në thelbin e pretendimeve të kërkuesit, Kolegji do të analizojë në vijim nëse ndërhyrja në rastin konkret, shkaktuar nga vendosja e masës së sigurimit pasuror të “sekuestros preventive” ndaj pasurisë së

paluajtshme të regjistruar në pronësi të kërkuesit, respekton kriterin kushtetues të kufizimit vetëm me ligj.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së pronës private

26. Gjykata ka pohuar se e drejta e pronës, e sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës, përfshin tre garanci që duhet të zbatohen në shqyrtimin e pretendimeve për cenimin e saj: garancia e parë ka të bëjë me parimin e gëzimit të qetë të pronës, e cila ka natyrë të përgjithshme; garancia e dytë ka të bëjë me kufizimet e lejueshme për të drejtën e pronës; garancia e tretë ka të bëjë me të drejtën e autoriteteve publike për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm (*shih vendimet nr. 33, datë 23.06.2025; nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 53, datë 31.10.2023*).

27. Për sa i përket ndërhyrjes që vendimi i sekuestrimit bën tek e drejta e pronës, Gjykata, ndër të tjera, ka theksuar se ajo duhet të jetë e ligjshme, në kuptimin që të jetë vendosur me ligj dhe të ndjekë një qëllim të ligjshëm, në kuptim të interesit publik. Ekziston një hapësirë e gjerë vlerësimi për autoritetet publike në lidhje me zgjedhjen e mjeteve dhe atë çfarë konsiderohet në interes të përgjithshëm, me përjashtim të rasteve kur vendimi është haptazi i paarsyeshëm. Ndërsa pranohet dyshimi i arsyeshëm në fillim të hetimeve penale si bazë për ndërhyrje në të drejtën e pronës, hetimet duhet të jenë të shpejta, në mënyrë që ndërhyrja të zgjasë për një kohë të kufizuar (*shih vendimet nr. 33, datë 23.06.2025; nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata ka pranuar se masa e sekuestrimit preventive ka natyrë parandaluese dhe synon të kufizojë përkohësisht disponimin e lirë edhe të një sendi produkt të veprës penale, me qëllim konfiskimin e tij në përfundim të procesit penal. Ajo vendoset gjatë procedimit penal dhe rëndon mbi pasurinë kur plotësohen kushtet ligjore. Dispozitat penale materiale dhe procedurale në lidhje me sekuestron preventive janë të aksesueshme, por edhe mjaftueshmërisht të qarta në drejtim të sendeve mbi të cilat ato mund të veprojnë (*shih vendimin nr. 33, datë 23.06.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, funksioni i të cilit është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 11, datë 10.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se vendimet e mospranimit të rekursit të

Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa në thelb shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Nga ana tjetër, Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë, të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyt atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 29, datë 01.11.2022 nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, pa përsëritur rrethanat e rastit të parashtruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, Kolegji vëren se masa hetimore e kundërshtuar nga kërkuesi është bazuar në parashikimet e ligjit procedural penal, sipas të cilit sekuestroja, si masë preventive e marrë gjatë procesit penal, kufizon të drejtën e disponimit të pasurisë së mbajtësit të saj. Për të garantuar këtë të drejtë (të pronës private) nga veprimet abuzive të organit procedues, ligji parashikon se ajo masë vendoset nga gjykata, e cila kontrollon edhe zbatimin e saj, ndërkohë që vendimet e gjykatës më të ulët i nënshtrohen kontrollit gjyqësor nga gjykatat më të larta. Konkretisht, masa e sekuestros preventive kërkohet nga prokurori dhe vendoset nga gjyqtari, dhe sipas nenit 274 të KPP-së ajo urdhërohet kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera (pika 1). Kurse sipas pikës 2 të këtij neni, sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të KP-së, i cili parashikon rastet e konfiskimit të mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit, ndër të tjera, të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale (pika 1, shkronja “b”).

31. Në kuptim të sa më sipër, në rastin konkret masa është vendosur nga gjyqtari i hetimeve paraprake mbi kërkesën e prokurorit, ndërsa vendimi i tij dhe zbatimi i masës në vijim i është nënshtruar kontrollit nga gjykatat më të larta. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara përmbajnë informacionin e nevojshëm në lidhje me arsyet e vendosjes dhe të zbatimit të masës së sekuestrimit, përkatësisht *periculum in mora* dhe *fumus delicti*. Gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar se ka ekzistuar një *periculum in mora* (rrezik vonese) në mosdhënien e një vendimi sekuestrimi, pasi pasojat e veprës penale mund të rëndoheshin ose të zgjateshin, ose mund të lehtësohej kryerja e veprave penale të tjera. Në të vërtetë, për shkak të zbulimit të të dhënave që ngrinin dyshime për veprimtari të paligjshme në fushën e trafikut ndërkombëtar të drogës, në kuadër të organizatës kriminale dhe për pastrimin e të ardhurave të siguruar nga kjo veprimtari kriminale edhe përmes investimit të tyre në sektorin e ndërtimit ose në sektorin imobiliar, me qëllim formalizimin e të ardhurave për llogari të anëtarëve të organizatës kriminale, si dhe ushtrimit të ndjekjes penale në vijim, ndërsa pasuria edhe më parë ishte tjetërsuar, ka ekzistuar rreziku që ajo mund të tjetërsohej sërish, çka do të pengonte ose vështirësonte konfiskimin e saj në përfundim të procesit penal. Për sa i përket çështjes së *fumus delicti*, gjykatat e zakonshme kanë pranuar se ky kusht përmbushej, duke qenë se vendimi i sekuestros po merrej në fazën e hetimit dhe se dyshimet për veprat penale që supozohej të kishin ndodhur ishin të besueshme. Në lidhje me këtë, ato kanë evidentuar detaje rreth dërgimit nga jashtë të të ardhurave nga anëtarët e dyshuar të organizatës kriminale dhe përdorimit të tyre në Shqipëri, ku është përfshirë edhe një shtetas (B), shoqëria në emër të vëllait të të cilit ka kryer edhe tjetërsimin e pronës në favor të kërkuarit, pronë kjo që më herët dyshohet se ka qenë e një prej anëtarëve të organizatës kriminale. Mbi këto të dhëna ato kanë pranuar ekzistencën e dyshimit për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprimtarisë kriminale, në kuadër organizatës kriminale, duke evidentuar edhe një lidhje të mundshme të pasurisë së kërkuarit me veprën penale dhe autorët e dyshuar të saj.

32. Kolegji vëren se edhe pse në dukje veprimi për kalimin e pasurisë në pronësi të kërkuarit është bërë përmes veprimeve të ligjshme, objekti i procedimit penal, në kuadër të të cilit është vendosur masa e kundërshtuar, lidhet me mënyrën e fitimit të kësaj prone në origjinë përmes veprimeve të dyshuara si të paligjshme. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh arsyetimin e gjykatave të zakonshme, në drejtim të mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të nenit 274 të KPP-së, si baza ligjore e zbatueshme edhe në rastin konkret, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për paligjshmëri të masës së sekuestros, me argumentet se ka vepruar në mirëbesim për fitimin e

pasurisë dhe se nuk është person nën hetim ose i dyshuar për veprën penale, nuk merr rëndësi në momentin në të cilin ndodhet procedimi penal, për sa kohë masa e kundërshtuar është vendosur në funksion të mbarëvajtjes së tij. Nga ana tjetër, nuk evidentohet ndonjë e dhënë ose tregues i qenësishëm për ligjshmërinë e fitimit të pronës në origjinë në kuptim të kushtit të *fumus delicti* për vendosjen e masës së kundërshtuar. Për pasojë, Kolegji vlerëson se përfundimi i gjykatave të zakonshme se masa e kundërshtuar është vendosur sipas ligjit, nuk është i paarsyeshëm ose arbitrar.

33. Në pikëpamje të garancive procedurale (*shih paragrafët sipër 21-22*), Kolegji vëren se ndonëse në aspektin e efektivitetit të masës së sekuestros, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka lëshuar një vendim të shkurtuar që përmbante pjesën urdhëruese (dispozitivin) të tij, me qëllim ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit për të shmangur tjetërsimin e mundshëm të pronave të sekuestruara, ajo gjykatë ka lëshuar edhe vendimin e arsyetuar, me të cilin kërkuesi, sikurse pranon, është njohur gjatë gjykimit të çështjes në apel, duke iu dhënë kështu mundësia për të parashtruar kundërshtime të mëtejshme në vijim të ankimit të tij. Po ashtu, ai ka pasur mundësi për të paraqitur prova në mbështetje të pretendimeve të tij, duke paraqitur të tilla në lidhje me ligjshmërinë e fitimit nga ai të pronësisë dhe burimin e të ardhurave të tij. Këto prova janë administruar nga gjykata e apelit, por në vlerësim të së cilës, por edhe të Gjykatës së Lartë, është konsideruar se ato nuk merrnin atë rëndësi në momentin në të cilin ndodhej procedimi penal, për sa kohë masa e kundërshtuar është vendosur në funksion të mbarëvajtjes së tij, duke nënkuptuar me këtë nevojën për verifikime, hetime të mëtejshme për shoshitjen e tyre me provat e siguruara në hetim në raport me objektin e tij. Gjykatat më të ulëta kanë treguar mjaftueshëm arsyet për të cilat kanë vlerësuar si të ligjshëm masën e sekuestrimit, duke i dhënë mundësi kërkuesit t'i kundërshtojë ato. Nga ana tjetër, edhe Gjykata e Lartë, ndonëse ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, ka parashtruar shkaqet e ngritura në të, sikundër edhe argumentet e saj për papranueshmërinë e tij për shqyrtim.

34. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së pronës private është haptazi i pabazuar, ndaj kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.